



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

FLETINFORMACION

PËR ÇËSHTJEN

Numri i çështjes:
KSC-BC-2020-06

Prokurori i Specializuar kundër:



Hashim Thaçi



Kadri Veseli



Rexhep Selimi



Jakup Krasniqi

Faza e çështjes:
GJYKIM

TË AKUZUARIT/AKUZAT

HASHIM THAÇI

Datëlindja: 24/04/1968

Funksionet e pretenduara gjatë periudhës së mbuluar prej Aktakuzës:

- Shef i Drejtorisë Politike dhe asaj të Informimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK);
- Kryeministër i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës (QPK) dhe
- Kryekomandant i UÇK-së.

KADRI VESELI

Datëlindja: 31/05/1967

Funksionet e pretenduara gjatë periudhës së mbuluar prej Aktakuzës:

- Anëtar i Drejtorisë Politike të UÇK-së dhe shef i shërbimit të zbulimit të UÇK-së;
- Shef i Shërbimit Informativ të Kosovës dhe Ministër i Shërbimit Informativ në QPK.

REXHEP SELIMI

Datëlindja: 15/03/1971

Funksionet e pretenduara gjatë periudhës së mbuluar prej Aktakuzës:

- Shef i Drejtorisë Operative të UÇK-së;
- Inspektor i Përgjithshëm i UÇK-së;
- Ministër i Rendit Publik/Ministër i Punëve të Brendshme në QPK.

JAKUP KRASNIQI

Datëlindja: 01/01/1951

Funksionet e pretenduara gjatë periudhës së mbuluar prej Aktakuzës:

- Anëtar i Drejtorisë Politike të UÇK-së dhe zëdhënës zyrtar i UÇK-së;
- Zëvendëskomandant i UÇK-së;
- Zëdhënës i QPK-së.

Përshkrimi i akuzave

Sipas Aktakuzës, krimet e paraqitura në të u kryen së paku që prej marsit 1998 deri në shtator 1999 në disa vendndodhje në Kosovë, si edhe në Kukës dhe Cahan, në Shqipërinë Veriore. Pretendohet se këto krime u kryen nga anëtarë të UÇK-së kundër qindra civilëve dhe personave që nuk merinin pjesë në luftime. Në Aktakuzë pretendohet se Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi kanë përgjegjësi penale individuale për krime që u kryen në kontekstin e një konflikti të armatosur jondërkombëtar në Kosovë dhe ishin pjesë e një sulmi gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër personave që dyshoheshin se ishin kundër UÇK-së.

Format e përgjegjësisë

Ndërmarrje kriminale e përbashkët
Ndihmë dhe inkurajim
Përgjegjësi penale si eprorë

Akuzat

1. Përndjekje (krime kundër njerëzimit)
2. Burgosje (krime kundër njerëzimit)
3. Arrestim dhe ndalim i paligjshëmose arbitrar (krime lufte)
4. Akte të tjera çnjerëzore (krime kundër njerëzimit)
5. Trajtim mizor (krime lufte)
6. Torturë (krime kundër njerëzimit)
7. Torturë (krime lufte)
8. Vrasje e paligjshme (krime kundër njerëzimit)
9. Vrasje e paligjshme (krime lufte)
10. Zhdukje me forcë e personave (krime kundër njerëzimit)

KRONOLOGJIA

Pas arrestimit të tyre nga Prokurori i Specializuar, Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi u transferuan në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë, më 4 dhe 5 nëntor 2020.

Gjatë paraqitjes së parë të tyre, nga 9 deri më 11 nëntor 2020, të katër të akuzuarit u vetëdeklaruan të pafajshëm në lidhje me të gjitha pikat e aktakuzës fillestare. Më vonë, ata gjithashtu u vetëdeklaruan të pafajshëm lidhur me akuzat e reja në aktakuzën e ndryshuar.

Më 15 dhjetor 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloi dosjen e çështjes gjyqësore Trupit Gjykses II.

Gjykimi filloi më 3 prill 2023 dhe në vijim e sipër është paraqitja e provave nga ZPS-ja.

STATISTIKAT E ÇËSHTJES*

Kohëzgjatja e procedurës paraprake	28 muaj e 30 ditë
Numri i viktimave pjesëmarrëse	143
Numri i ditëve të gjyqimit në sallën e gjyqit	101
Numri i dëshmitarëve në sallën e gjyqit	54 (ZPS)

* Më 15/04/2024

TË CAKTUAR NË KËTË ÇËSHTJE

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE



Gjykatës Nikola Giju

TRUPI GJYKUES II



Gjykatës Çarls Smith III
(Kryegjykatës)



Gjykatës Kristof Barte



Gjykatës Ginel Metro



Gjykatës Fergal Gejnor
(gjykatës rezervë)

ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR (PËRFAQËSUESIT KRYESORË)



Alan Tiger



Kler Loson

MBROJTJA (MBROJTËSIT KRYESORË)



Luka Mishetiq (për H.
Thaçin)



Ben Emerson (për K.
Veselin)



Xhefri Roberts (për R.
Selimin)



Venkatesvari Alagendra
(për J. Krasniqin)

MBROJTËSI I VIKTIMAVE



Sajmon Loz


Për më shumë informacion përdorni kamerën e telefonit tuaj
për të skanuar kodet e mëposhtme:




Faqja e çështjeve gjyqësore




Kalendari i gjykatës




Faqja e aktualiteteve



Kanali Youtube i DSHK-së



Profili X i DSHK-së



Profili Instagram i DSHK-së



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA



DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS / FLETINFORMACION PËR ÇËSHTJEN